



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Punë Publike

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Rikonstruktion i Ujësjellësit fshati Kafaraj, Çerven, Adë, Bashkia Fier”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për ujësjellës 45247130-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 66,500,000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kritere te Përgjithshme të Përzgjedhjes /Kualifikimit, sipas Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikës 1, Shtojca7.

❖ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **bilancet vjetore**, për vitet financiare (2021,2022,2023) të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*"(i ndryshuar). Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*".

2.2.2 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin për **xhiron vjetore** për vitet financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros minimale vjetore që kërkohet, të jetë **jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit)**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 i LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*".

Përcaktimi i vlerës dhe viteve të kërkuara argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues dhe përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetime që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, **të taksave dhe tarifave vendore**, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*"(i ndryshuar), në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së , për vitin **2024 (këstet e maturuara)**.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "*Per procedurat tatimore*" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "*Për QKB*" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "*Për QKR*" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë **përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme** dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- **Për kontrata të realizuara me ente publike** operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certificate marrje në dorzim të perkohshme ose të perhershme.
- **Për kontrata të realizuara me sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; **Nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të **VKM Nr.285 datë 19.05.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterëve për punë të ngjashme si më lart, bëhet sepse këto kriterë janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas pikës 8 të nenit 39 të VKM së sipërcituar, grupi i punës vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që OE pjesëmarrës, krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse OE zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punime të mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim OE, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë

Autoritetet Kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben AK për t'u siguruar që OE kanë kapacitetin e nevojshëm për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **licencën profesionale të shoqërisë**, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **Kategoria NP-1** Punime germimi ne toke **Klasifikimi B**
- **Kategoria NP-4** Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai..... **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-5** Punime nëntoksore, ura e vepra arti **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-7** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje **Klasifikimi D**
- **Kategoria NP-12** Punime te inxhinierise se mjedisit **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 9** Punime strukturore speciale **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

Argumentimi: Bazuar në nenin 39“*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “*Përmiratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”.

VKM Nr.42 datë 16.01.2008 (indryshuar) “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” (lidhja 2,3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”(të ndryshuar), AK vlerëson se OE pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.

Sipas VKM Nr.42 datë 16.01.2008 (e ndryshuar):

Kategoria N.P-1“*Punime germimi në tokë*” është kërkuar duke patur parasysh se parashikohen në preventive Punime germimi e mbushje i kryesor dhe punime germimi e mbushje dhe kanalizime të lidhjeve të pusetave.

Kategoria NP- 4 “*Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha ...*”,

Kjo kategori licence I referohet punimeve të parashikuara në preventiv sic është prerje asfalti, punime shtresash, etj.

Kategoria N.P-5 “*Punime nëntokësore*”, Konsiderohen ndërtime mirëmbajtje ose ristrukturim, me anë të përdorimit të mjeteve teknikes peciale, të ndëhyrjeve nëntoke..., punime të mureve mbajtës etj.

Kategoria N.P-7 “*Ujesjellës, gazsjellës, vajsjellës, veprakullimi e vaditje*”. Kjo kategori licence I referohet objektit të kontratës dhe punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht furnizim vendosje tuba PE, punime në puseta, linjat e shperndarjes etj.

Kategoria NP-12 “*Punime të inxhinierisë së mjedisit*”. Kjo kategori license është vendosur duke patur parasysh se punimet duhet të kryhen me kujdes për të mos prishur strukturën e tokës, rehabilitimi i tokës do të kryhet pas punimeve të ndërtimit si edhe depozitimi i mbetjeve nga gërmimet apo prishjet në vendodhjet e percaktuara.

Kategoria N.S-9 “*Punime strukturore speciale*”. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të çfardollos tipit, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtës, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale.

Kategoria NS 18 “*Punime topogjeodezike*”. Është vendosur në përputhje me punimet që do të realizohen bazuar në projektine zbatimit dhe në preventivë punimeve, kjo kategori license është e domosdoshme për piktetimet e kanaleve që do të gërmohen dhe sistemeve topografike.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) **Kodi III.2.B** “*Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte*”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “*Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta*”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, datë 11.05.2009 “*Per disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Sipas punimeve të projektit punime të gërmimeve (dheu, kanale), (prerje) sistemim territori etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në vend-depozitimet e miratuara, bazuar në nenet 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”;

VKM nr.575, datë 24.06.2015 “*Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte*” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, AK vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “*Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, në përputhje me përcaktimet e VKM nr.538, datë 26.05.2009 “*Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën **30 (tridhjetë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- Listepagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi, minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (indryshuar).

Argumentimi: Bazuar në nenin 39 “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*” pika 6, gërma “ç” të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (indryshuar).

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar nëse operatorët ekonomik kanë stafin e nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 30 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës.

Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, është marrë parasysh numri i punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në DST, për periudhën *120 ditë kalendarike*, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të renda etj., duke patur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve, punime këto të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit në grafikun e punimeve, gjithsej 4 muaj, lind nevoja për këtë fuqi të përcaktuar punëtore.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar **staf inxhinierik drejtues teknik** për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën për 3 (tre) muajt e fundit, konkretisht;

- a) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi - Profili Gjeoteknik
- b) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi – Profili Infrastruktur Transporti
- c) 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- d) 1 (një) Inxhinier Topograf
- e) 1 (një) Inxhinier Mekanik
- f) 1 (një) Inxhinier Mjedisi - Trajtimi i ujerave

Për inxhinieret drejtues teknik si mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë;
- CV

Argumentimi: Bazuar në nenin 39 pika 6, gërma/c “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*” të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (I ndryshuar). Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar nëse operatorët ekonomik disponojnë stafin e nevojshëm dhe profesional për të zbatuar objektin e prokurimit.

- Është kërkuar **inxhinier ndërtimi Profili Gjeoteknik**, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve si: punime gërmimi etj..
- Është kërkuar **inxhinier ndërtimi Profili Infrastruktur Transporti**, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve si: shtresa asfaltike etj
- Është kërkuar **inxhinier hidroteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve volumin ose hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve, furnizim vendosjen e tubacioneve dhe rakorderive të ujësjellësit përgjatë rrjetit.
- Është kërkuar **inxhinier topograf** pasi do të kryejë azhornimin topografik sipas terrenit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit.

- Është kërkuar **Inxhinier Mekanik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve volumin ose hidraulike lidhur me zërat e preventivave të punimeve, furnizim vendosjen e tubacioneve dhe rakorderive të ujës-jellësit përgjatë rrjetit.
- Është kërkuar **Inxhinier Mjedisi - Trajtimi i ujerave** referuar preventivit të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **NP 12A** është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Mjedisit i cili do të beje mbikqyrjen e vazhdueshme të ndikimit në mjedis që ka zbatimi i punimeve objekt kontrate.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si **staf teknik për kryerjen e punimeve**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, pajisur me diploma/certifikata të formimit profesional lëshuar nga Autoritete përgjegjëse të akredituara/licensuara si dhe dëshmi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës teknik Ndërtimi
- 1 (nje) punonjës teknik Topograf
- 1 (nje) punonjës teknik Mekanik
- 1 (një) punonjës teknik Hidraulik
- 2 (dy) punonjës hidraulik
- 1 (një) punonjës montator
- 2 (dy) punonjës saldator
- 2 (dy) punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës karpentiere
- 2 (dy) punonjës betonues
- 2 (dy) punonjës bojaxhi
- 2 (dy) punonjës për punime në rrugë dhe asfaltim
- 3 (tre) eskavatorist
- 4 (katër) punonjës shofera
- 3 (tre) automakinist
- 1 (një) punonjës buldozerist

Për këta punonjës (1-13), operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (diplomë profesionale/certificate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
 - Për punonjësit manovrator/shofer/automakinist/buldozerist, ofertuesi duhet të paraqesë: Kontratën individuale të punës të vlefshme; leje drejtimi, certificate e aftësisë profesionale për shofer; dëshmi e aftësisë profesionale për manovrator/automakinist/buldozerist; Në rastin kur mjetet e kërkuara janë të marra me qera, punonjësit (Manovrator/shofer) nuk kërkohet të figurojnë në liste pagesat e shoqërisë, mund të kontraktohen me kontratë pune.

Argumentimi: Bazuar në nenin 39 pika 6, gërma/c “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar nëse operatorët ekonomik disponojnë stafin e nevojshëm dhe profesional për të zbatuar objektin e prokurimit.

- **Teknik ndërtimi**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Hidraulikë**, të cilët sic parashtruar më lart janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve ku punimet hidraulike zënë një pjesë të konsiderueshme të punimeve të kontratës.
- Punonjes **teknik topograf**, i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të piketimit dhe matje topografike, duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- Punonjes **teknik mekanik**, i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të piketimit dhe matje topografike, duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- Punonjes **teknik Hidraulik**, i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të piketimit dhe matje topografike, duke patur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve
- Punonjësit **saldatorë** janë kërkuar për kryerjen e të gjitha punimeve që kanë të bëjnë me rrjetin e ujësjellësit, montimin e tubave dhe rakorderive. Këto përcaktime janë bërë edhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.
- Specialistët **karpentier** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke patur parasysh volumin e punimeve (referuar preventivit).
- Punonjësit **montatorë** janë kërkuar pasi është e rëndësishme që gjatë realizimit të proceseve të punës të asistohen nga personel për montimin e tubave që kanë diameter dhe peshë të konsiderueshme dhe rakorderive.
- Punonjes **Hekurkthyes**, janë kërkuar për punimet e hekurit, sipas zërave të preventivit.
- Punonjes **betonues**, të cilët janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve të betonimit të cilat zënë një volum të konsiderueshëm pune.
- Punonjes për **punime në rrugë dhe asfaltim** janë kërkuar pasi është e rëndësishme për realizimin e proceseve të punës së shtresave asfaltike, asfalto beton.
- **Shoferët** janë punonjës të cilët do të jenë përgjegjës për ecurinë e mjeteve të transportit dhe rasteve, inerteve etj, të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti.
- **Auto-makinistët** janë punonjës të kualifikuar sipas legjislacionit në fuqi për drejtimin e mjeteve ATP, autobetoniere, autopompa dhe autovinça, të cilët janë perlllogaritur si mjetet e nevojshme për realizimin e punimeve të preventivit.
- Punonjës **buldozerist** për drejtimin e mjetit buldozer.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet I përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përpunonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personeltëkualifikuar/ certifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/ certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 (tre) muajt e fundit të paktën;

- **1(një) specialist Ekspert Zjarrfikës** ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, ne mbështetje te pikës 4 te nenit 49 te Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", te pajisur me certifikate te lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
- **1(një) Mjek të përgjithshëm**, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, ku për përmbushjen e këtij kushti te jete i shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme ose kontratë shërbimi te vlefshme (ne rastin kur OE nuk disponon nje te tille), Licensen lëshuar nga Urdhëri i Mjekut, Diplomë

Argumentimi: Bazuar në nenin 39 pika 6, gërma/c “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar nëse operatorët ekonomik disponojnë stafin e nevojshëm dhe profesional për të zbatuar objektin e prokurimit.

Është kërkuar 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” bazuar në Ligjin Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.

Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Është kërkuar Ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar nga Drejtoria e MZSH-së. Për përmbushjen e këtij kriteri Operatori ekonomikë duhet të paraqesë Certifikatat e Trajnimit/Dëshmi kualifikimi për inxhinierin përkatës.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjermën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3.8 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- **TubaUjësjellësi**
- **Rakorderi Ujësjellësi**
- **Matësa Uji**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- **Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit** ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

- **Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve** për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK, që OE ofertues do të paraqesë mallrat që duhen për të realizuar punimet, sipas specifikimeve teknike të projektit. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

d) Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certificate ose deklaratë nga prodhuesi/ distributor I autorizuar që vërteton se standarti I prodhimit të matesave të ujit sipas OIML R49/ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.

Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID/ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015 (ose "ekuivalente")** e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015 ose "ekuivalente"** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018 ose "ekuivalente"** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO të vlefshme, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.2 është vendosur sipas nenit 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në nenin 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet kompetente për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë duke mundur realizimin në kohë, dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara.

2.3.10 Operatori ekonomik të paraqesë Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
A.	MAKINERI TEKNOLOGJIKE DHE MJETE		
1	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	1
2	Eskavator me goma me targa (mt)	në pronësi ose me qira	2
3	Autovincme kapacitet mbajtës jo më pak se 6 ton deri 8 ton	në pronësi ose me qira	2
4	Matrapik	në pronësi ose me qira	1

5	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton deri 14 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
6	Autobot uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
7	Rrul vibrues (ngjeshes) mbi 8 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
8	Fadrome me kove para dhe krahe mbrapa/skrep me targa	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
9	Autobitumatrice	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
11	Grejder me gomame targa (mt)	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
12	Minifadroma me goma me targa (mt)	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
13	Kamione me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
14	Kamioncina me kapacitet mbajtes 1.5 ton deri ne 3.5 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
15	Dumper me gomame targa (mt)	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
16	RTV - Transportier per mjete te renda	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
B	Emri i pajisjeve		
1	Aparatngjitje tuba ujesjellesi	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
2	Betoniere kantieri (0.10-0.35 m3)	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
3	Vibrator betoni	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
4	Elektro-saldatriçe	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
5	Moto gjenerator	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
6	Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
7	Cekic pneumatik	Pronësiose me qera	2
8	Kompresor ajri	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
9	Fabrike Nyje prodhim Inertesh e pajisur me leje mjedisore te vlefshme	Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	1
10	Fabrike prodhimi te asfalto betonit	Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	1

- *Eskavator me zinxhir* ky mjet është kërkuar për hapjen e kanaleve në rrugë dhe terrene të vështira
- *Eskvator me goma me targa (mt)* ky mjet është kërkuar për hapjen e kanaleve në rrugë të asfaltuara
- *Autovinc me kapacitet mbajtës jo më pak se 6 ton deri 8 ton* ky mjet është kërkuar për ngritjen e materialeve të ndërtimit
- *Matrapik* është kërkuar për prishjen e betoneve në rrugë ose terrene të tjera
- *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton deri 14 ton* janë kërkuar për transportin e bazës materiale
- *Autobot uji* për pastrimin e sipërfaqes pas punimeve
- *Rrul vibrues (ngjeshës) mbi 8 ton* për ngjeshjen e rrugës për kthimin në gjendjen e mëparshme
- *Fadromë me kovë para dhe krahë mbrapa/skrep me targa* për hapjen e kanaleve dhe inerteve
- *Auto bitumatrice* për asfaltimin e rrugës pas kryerjes së punimeve
- *Grejder me goma me targa (mt)* për grryerje të rrugës
- *Minifadroma me goma me targa (mt)* për hapje inerte në terrene të ngushta
- *Kamione me kapacitet mbajtës mbi 20 ton* për transportin e inerteve
- *Kamioncina me kapacitet mbajtës 1.5 ton deri në 3.5 ton* për transport baze materiale dhe vegla pune
- *Dumper me goma me targa (mt)* transport inertesh
- *RTV - Transportier për mjete të rënda* për transport të makinerive të rënda

- Kokore minimumi 100 copë
- Jeleke fosforeshent 100 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Shënim: Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

- a) Për makineri dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;
- b) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- c) Për makineri dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.
- d) Për impiantin e asfaltit, duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë.
Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.
- e) Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- f) Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje.
- g) Ndërsa për paisjet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimi/faturë tatimore blerje) e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri dhe mjete dhe pajisje të deklaruar.
- i) Për makineritë dhe mjetet, fotoja duhet të kete të dallueshme edhe targën e mjetit.
- j) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këtodokumentet duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim në vëmendje se:

- Disponimi I punonjësve dhe I mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar I pari nëpërmjet SPE që të dorëzojë dokumentet provuese për vetë-deklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi I mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore, teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr.285 datë 19.5.2021 kucitohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon...**mjetet e pajisjet teknike**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT: